



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

**UDHËZUES PËR APLIKIM NË THIRRJEN PUBLIKE PËR
SUBVENCIONIM ME MJETE FINANCIARE PËR ARTIZANE DHE
KRITERET PËR APLIKUESIT**

SKEMA E GRANTEVE

**Përkrahja e ndërmarrjeve mikro dhe të vogla për zhvillimin e
artizaneve**

Autoriteti kontraktues: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT)

Autoriteti zbatues: Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
(KIESA)

Afati për dorëzimin e aplikacionit dhe dokumenteve përcjellëse:
Nga data 12.07.2024 deri më datë 01.08.2024

Përmbajtja

1. Hyrje
2. Përkrahja financiare e ofruar nga MINT/KIESA
3. Dokumentet e kërkuara sipas Udhëzimit Administrativ (MTI) nr. 01/2018 për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve
4. Subjektet afariste që nuk kualifikohen
5. Kohëzgjatja
6. Sqarime shtesë
7. Si të aplikohet
8. Kriteret e vlerësimit
9. Ankesat

1. Hyrje

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), lanson skemën e granteve për blerje të veglave dhe pajisjeve prodhuese/përpunuese, lëndës së parë dhe për promovim/marketing të produkteve apo proceseve për sektorin privat, në veçanti për zejtarët artizanë.

Box 1:

“Zejtaria tradicionale”, është krijimi ose rikrijimi i gjërave të caktuara në mënyrë jo industriale, në sasi të vogla, bazuar kryesisht në punën me dorë dhe dije bërjen e trashëguar të vendit tonë. Këtu përfshihen artizanati dhe artizanati shtëpiak.

“Artizanati”, nënkupton punimin dhe përpunimin e gjërave të artit si dhe formësimi i tyre, cilësia e të cilave varet nga shkathtësia e prodhuesit. Artizanati prodhohet me dorë e me mjete të thjeshta nga zejtarët, dhe që nuk prodhohet në fabrikë.

“Artizanati shtëpiak”, nënkupton punimin e produkteve të veçanta, të cilat zeytari i punon vetë ose me anëtarët e familjes.

“Punëtorët artizanalë”, kombinojnë aftësitë artistike dhe manuale për të dizajnuar, bërë, riparuar, rregulluar, mirëmbajtur dhe dekoruar instrumentet e precizonit, instrumentet muzikore, bizhuteritë dhe metalet e tjera të çmuara, poçet dhe enët prej porcelani. Ata aplikojnë teknika tradicionale dhe/ose të zhvilluara së fundi për të gdhendur, formuar, montuar, thurur dhe dekoruar artikuj të ndryshëm qelqi, tekstile, kashte, guri, druri dhe lëkure.

“Vegla/pajisje”, nënkupton veglat ose pajisjet e destinuara për procesin prodhues ose përpunues.

Kjo grant skemë ka për qëllim krijimin, zhvillimin dhe forcimin e mëtejshëm të artizaneve, përfshirë promovimin, mbrojtjen, ruajtjen dhe përcjelljen e artizanatit tradicional.

Sipas analizës së performancës industriale dhe në mbështetje të bizneseve, janë identifikuar nën sektorët me potencial më të lartë për të arritur plotësimin e objektivave dhe politikave të ndërmarrësisë. Prandaj, grant skema ka për qëllim të kontribuojë në rritjen e prodhimit dhe përpunimit, përmirësimin e bilancit tregtar përmes rritjes së eksportit apo rritjes së pjesëmarrjes së produkteve në tregun vendor, rritjes së investimeve dhe punësimit, duke përfshirë edhe nxitjen e bizneseve që të kontribuojnë dhe përfitojnë përmes ekonomisë qarkore.

MINT, respektivisht KIESA fton zejtarët artizanë (ndërmarrjet mikro dhe të vogla) që të aplikojnë për përkrahje financiare përmes kësaj skeme sipas Klasifikimit të Veprimtarive Ekonomike (NACE Rev.2), ku veprimtaria e tyre duhet të jetë në fushën e artizanateve, e cila përfshihet në kodet si në vijim:

☐	Kodi 13	Prodhimi i tekstilit
☐	Kodi 14	Prodhimi i veshjeve
☐	Kodi 15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës
☐	Kodi 16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilieve; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurëse
☐	Kodi 23	Prodhimi i produkteve minerale jometalike
☐	Kodi 24	Prodhimi i metaleve
☐	Kodi 25	Prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve
☐	Kodi 32	Prodhimi tjetër p.k.t.

Shënim:

Në përgjithësi duke u bazuar në Klasifikimin e Veprimtarive Ekonomike (NACE Rev.2), subjektet afariste që kanë të drejtë të aplikojnë në këtë thirrje janë artizanatet që krijojnë ose rikrijojnë produkte të caktuara në mënyrë jo industriale (që nuk prodhohet në fabrikë), në sasi të vogla, bazuar kryesisht në punën me dorë, ku punimi dhe përpunimi i gjërave të artit si dhe formësimi i tyre dhe cilësia varet nga shkathtësia e prodhuesit. Disa nga artizanatet, por jo vetëm janë:

- Filigrani (formë e përpunimit të ndërlikuar të metaleve duke filluar nga stolitë delikate prej ari e deri te kangjella prej gize dhe balustrada);
- Veshjet popullore (xhubletë, pantallona, shajaku, opinga me majë me zbukurime te femrat);
- Zdrukthëtaria (korniza dhe struktura druri dhe materiale tjera);
- Këpucaria (prodhimi i këpucëve që sot është shumë i shtypur nga prodhimi industrial dhe mallrat që ofrohen në treg shumë më lirë se artizanati);
- Qilim dhe sixhade tradicionale (punime etnokulturore me mjeshtëri dhe ngjyra natyrale);
- Poçarët (enë prej balte);
- Teneqepunues;
- Farkëtarë;
- Opingat dhe nallanet (këpucë të forta që ishin më të mira në ujë dhe nxehtësi sesa këpucët konvencionale me taban lëkure).

2. Përkrahja financiare e ofruar nga MINT/KIESA

Shuma totale e kësaj thirrje është 400,000.00€. Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion. Grantet do të ndahen përmes dy kategorive si në vijim:

- Lot 1 - Ndërmarrjet mikro, të punësuar deri në 9 punëtorë mund të përfitojnë në vlerë maksimale deri në 5,000.00€. Buxheti për këtë kategori është 250,000.00 €. Numri i ndërmarrjeve përfituese është 50, por mbetet në diskrecion të autoritetit kontraktues që ky numër të finalizohet sipas thirrjes dhe nevojave të thirrjes.

- Lot 2 - Ndërmarrjet e vogla, të punësuar 10 deri 49 punëtorë mund të përfitojnë në vlerë maksimale deri në 10,000.00€. Buxheti për këtë kategori është 150,000.00€. Numri i ndërmarrjeve përfituese është 15, por mbetet në diskrecion të autoritetit kontraktues që ky numër të finalizohet sipas thirrjes dhe nevojave të thirrjes.

Shënim:

Në rast se nuk plotësohet kuota e ndonjërit Lot, atëherë teprica e buxhetit mund të bartet në Lot-et tjera. Përfituesit e granteve duhet të bashkë financojnë realizimin e projektit si në vijim:

Lot 1 - jo më pak se 10%

Lot 2 - jo më pak se 20%

3. Dokumentet e kërkuara sipas Udhëzimit Administrativ (MTI) nr. 01/2018 për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Certifikatën e numrit fiskal (nuk aplikohet për bizneset të cilat numrin e regjistrimit të biznesit dhe numrin fiskal e kanë në një certifikatë).
- Vërtetim tatimor me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK.
- Kopjen e letërnjoftimit të personit/ve në emër të cilit/ve është i regjistruar aplikuesi.
- Dëshmi nga aplikuesi se nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Themelore - kërkohet origjinali jo më i vjetër se 30 ditë.
- Dëshminë e xhirollogarisë aktive të aplikuesit në njërën prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.
- Gjendjen e xhirollogarisë bankare të aplikuesit për vitin e fundit (2023). Për aplikuesin e sapo themeluar kjo nuk është e aplikueshme.
- Projekt-propozimin që përfshin: qëllimin, aktivitetet e projektit, koston financiare, planin kohor të realizimit të projektit dhe strukturën organizative të aplikuesit.¹
- Të mos ketë pranuar mjete nga burimet tjera të financimit për të njëjtat aktivitete, të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit nga MINT për dy vitet e fundit, si dhe veprimtarinë që është artizan. Të gjitha të dëshmuara me një deklaratë nën betim, sipas Shtojcës D.

¹ Forma e projekt propozimit që duhet të plotësohet mund të shkarkohet nga portali e-Kosova.

- Listën e punëtorëve për vitin 2023 të lëshuar nga ATK (mund të nxjerrët online nga ueb faqja e ATK-së). Në bazë të listës do të kategorizohen dhe vlerësohen ndërmarrjet si: mikro dhe të vogla, dhe do të vlerësohen pikët e punësimit të gjinisë femërore.²
- Oferta për vegla/pajisje dhe lëndë të parë nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së kësaj thirrjes dhe duhet të ketë vlerën në euro.
- Qarkullimi për vitin 2022 dhe 2023 të dëshmohet me dokument të lëshuar nga ATK. Për aplikuesin e sapo themeluar (2024) kjo nuk është e aplikueshme.
- Fotot e punimeve artizanale.

Në harmoni me kriteret e lartpërmendura, pako e aplikuesit duhet të përmbajë:

Shtojcën A – Aplikacioni

Shtojcën B - Buxheti

Shtojcën C - Deklaratat nën betim

Sqarim:

Në mungesë të cilit do dokument të kërkuar më lartë, përfshirë shtojcat, subjektet aplikuese do të diskualifikohen dhe nuk do të shqyrtohen për vlerësim.

4. Subjektet afariste që nuk kualifikohen

Subjektet afariste të cilat kanë bankrotuar apo janë në mbyllje, janë nën administrim të gjykatave, kanë pezulluar aktivitetet afariste, apo i janë nënshtruar procedurave në lidhje me këto çështje, nuk mund të marrin pjesë në thirrje apo të jenë përfitues të skemës së granteve.

5. Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e planifikuar e projektit që financohet nga MINT/KIESA nuk mund të tejkalojë katër (4) muaj që nga nënshkrimi i kontratës ndërmjet dy palëve (përveç nëse ndryshe parashihet me kushtet e kontratës apo raportit të komisionit monitorues).

6. Sqarime shtesë

- Aplikacionet mund të plotësohen në gjuhën shqipe ose serbe.
- Aplikuesi, në projekt propozim dhe planifikimin buxhetor duhet të prezantoj pjesëmarrjen e financimit vetanak.
- Bizneset që kanë përfituar subvencione në kuadër të KIESA-s brenda vitit 2024, nuk mund të jenë përfitues në këtë skemë.
- Në rast që subjekti do të jetë përfitues, atëherë do të nënshkruhet marrëveshje dypalëshe (MINT/KIESA dhe subjekti), pjesë e secilës do të jenë edhe deklaratimet që janë bërë me rastin e aplikimit.

² Lista e punëtorëve për vitin 2023 e lëshuar nga ATK me emrin e subjektit aplikues në harmoni me NUI.

- Fushë veprimtaria e ndërmarrjeve duhet të jetë në harmoni me sektorët sipas Klasifikimit të Veprimtarive Ekonomike (NACE Rev.2) dhe nuk pranohet asnjë ndryshim-plotësim pas hapjes së kësaj thirrje publike.
- Pas nënshkrimit të marrëveshjes, subjektit përfitues do t'i transferohen 80% e vlerës së aprovuar, ndërsa 20% e vlerës së mbetur do t'i transferohen pas realizimit të projektit.
- TVSH është shpenzim i pranueshëm vetëm për subjektet jo deklaruese të TVSH-se. Për subjektet që janë deklaruese të TVSH-së, ky është shpenzim i papranueshëm.
- Veglat/pajisjet prodhuese/përpunuese të cilat kërkohen të subvencionohen nuk lejohen të shiten brenda tre (3) viteve. Kjo do të jetë pjesë e marrëveshjes së bashkëfinancimit.
- Përfitues do të jenë subjektet që janë renditur me pikë më të larta nga komisioni vlerësues, varësisht prej limiteve buxhetore të planifikuara.
- Ndryshimi i ofertës mund të bëhet vetëm me kërkesë të veçantë, e cila parashtrohet në MINT/KIESA, respektivisht në komisionin monitorues. Kërkesa duhet të mbështetet në arsye të qëndrueshme nga përfituesi dhe e njëjta mund të implementohet vetëm pas miratimit të kërkesës dhe nuk ndryshohet koncepti i projektit dhe shuma e grantit nga Ministria. Në rastet kur kemi ofertues me çmime më të larta se ato të prezantuara në projektin aplikues, atëherë ndryshimet e çmimeve janë obligim i përfituesit dhe në asnjë rast nuk ndryshon vlera e grantit nga Ministria.
- Sa i përket shpenzimeve të pranueshme, sipas kësaj thirrje publike për financim do të përkrahen vetëm aktivitetet e kualifikuara si: Blerja e veglave/pajisjeve që mund t'i ndihmojnë biznesin ta zhvillojnë projektin artizan; blerja e lëndës së parë për prodhim dhe përpunim për zhvillimin e projektit artizan; dhe/ose shpenzimet për promovim/marketing të produkteve apo proceseve artizane.
- Në ueb të MINT/KIESA do të publikohet lista e ndërmarrjeve të vlerësuara.

Shënim:

Shpenzimet për lëndë të parë nuk duhet të tejkalojnë 40% të shumës totale të projektit. Shpenzimet për promovim nuk duhet të tejkalojnë 20% të shumës totale të projektit.

7. Si të aplikohet?

Njoftimi për thirrje publike është i publikuar në ueb faqen e MINT dhe të KIESA-së:

- ☐ <https://mint.rks-gov.net/>
- ☐ <http://kiesa.rks-gov.net/>

Aplikimi bëhet përmes platformës e-Kosova. Afati për dorëzimin e aplikacionit dhe dokumenteve përcjellëse është deri më datë 01.08.2024. Ndërsa, informatat shtesë mund të merren përmes email adresës: sme.kiesa@rks-gov.net konform UA (MTI) nr. 01/2018, jo më vonë se pesë (5) ditë para mbylljes së thirrjes publike.

8. Kriteret e vlerësimit

#	Vlerësimi	Pikët maksimale	
		Lot 1 (mikro)	Lot 2 (e vogël)
1	Projekt propozimi ³	30	30
2	Produktet artizanale ekzistuese që prodhohen ⁴	20	20
3	Numri i produkteve të reja që planifikoni të krijoni nga trashëgimia jonë artizanale ⁵	20	20
4	Rritja e qarkullimit, e dëshmuar nga ATK ⁶	10	10
5	Përqindja e të punësuarve të gjinisë femërore, nga një (1) pikë për çdo 10% të të punësuarve të gjinisë femërore	10	10
6	Rritja e punësimit	Nga 5 pikë për çdo një të ri të punësuar	Nga 3.33 pikë për çdo një të ri të punësuar
		10	10

9. Ankesat

Pas publikimit të rezultateve preliminare aplikuesit mund të adresojnë ankesa brenda afatit të paraparë me Udhëzimin Administrativ (MTI) nr. 01/2018 për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, në platformën e-Kosova.

Shënim:

Në rast se informatat e dhëna në këtë aplikacion vërtetohen që janë të pa sakta, subjektit nuk do t'i realizohet pagesa dhe i njëjti do të mbaj përgjegjësi për të gjitha pasojat, sipas legjislacioneve relevante në fuqi.

³ Të paraqiten në projekt propozim, qëllimi, aktivitetet e projektit, kosto financiare, plani kohor i projektit, struktura organizative e subjektit, kapacitetet aktuale prodhuese dhe synimet e rritjes së prodhimit dhe eksportit, apo zëvendësimit të importit në rast të përfitimit të grantit, rëndësia e propozimit me prioritetet e thirrjes, sektorët dhe specifikat e tjera, sa i adreson propozimi i projektit pengesat strukturore të atij sektori, çfarë vlere të shtuar ka projekti për vendin, sa janë aktivitetet e realizueshme dhe të qëndrueshme në lidhje me rezultatet e pritshme dhe rreziqet e mundshme, si dhe mënyra e implementimit. Propozimet do të vlerësohen bazuar në qartësinë dhe dallueshmërinë e projektit, përfshirë pozicionimin e tij në treg dhe potencialin e tij për rritje.

⁴ Produktet ose krijimtaria artizanale që prodhohen/krijohen nga aplikuesi të dëshmohen me emërtime, foto dhe karakteristikat e produktit.

⁵ Emërtimi, foto dhe përshkrimi i produkteve ose krijimtarisë që planifikohen të prodhohen ose krijohen nga trashëgimia jonë artizanale dhe a inkorporojnë vlerë të shtuar këto produkte/krijime.

⁶ Kjo nënkupton krahasimin e rritjes së qarkullimit për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022 (për aplikuesin e sapo themeluar kjo nuk është e aplikueshme).